



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:151117

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441133

KP.nr. 162/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS” Sh.A, me seli në Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit F.S., ndaj të paditurit Renta Car “Velori” Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti liri i pronës dhe pagesa e borxhit, jashtë seance më datën 12.03.2024 merr këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia –

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infakos” Sh.a, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri Renta Car “Velori” Sh.p.k, që paditësit ti paguajnë në emër të qirasë për shfrytëzimin e pronës në sipërfaqe prej 115m², të evidentuar sipas fletës poseduese 10317 ZK Prishtinë, e sipas kontratës nr. 18/737 për periudhën kohore nga 01.09.2018 deri më 31.08.2019 në shumë totale prej 537.36 euro, dhe të obligohet i padituri që të bëjë lirim të pronës nga njerëzit dhe sendet dhe të njëjtën ti dorëzoj paditësit në gjendjen e mëparshme.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 22.07.2022 në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka ushtruar padi ndaj të paditurit me kërkesë për lirim të pronës dhe pagesën e borxhit.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 22.02.2024, e ka njoftuar gjykatën se me të paditurin kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore për përmbushje të detyrimit i cili rrjedhë sipas kontratës me numër 17/737 të datës 1.08.2018 dhe të njëjtën me vullnetin e të dy palëve e

kanë nënshkruar, ashtu që pas arritjes së marrëveshjes për përmbushjen e obligimit ka deklaruar se heqë dorë nga kërkesë padia dhe tërhiqet nga padia.

Sipas dispozitës së nenit 149.1, të LPK-së, përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heq dorë nga një pjesë e kërkesë padisë apo nga e gjithë kërkesëpadia gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykim në bazë të heqjes dorë)”*, ndërsa me pikën 2, të po të njëjtit nen shprehimisht përcaktohet *“për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës se paditur”*.

Bazuar në deklaratimet e të autorizuarit të paditësit sipas parashtrës së datës 22.02.2024 se heqë dorë nga kërkesë padia dhe tërhiqet nga padia në tërësi sa i përket lirimit të pronës dhe pagesës së borxhit.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 149, lidhur me nenin 388, të LPK-së, gjeti se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që gjykata të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, në të cilin është përcaktuar se *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.162/23, datë 12.03.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.